



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



RESPEKTI I TË DREJTAVE SOCIALE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË NIVEL VENDOR

Cfarë është pagesa e aftësisë së kufizuar?

Pagesa e aftësisë së kufizuar është një pagesë mujore që u jepet personave me aftësi të kufizuar me qëllim mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së tyre të jetesës.



Roli i njësive të qeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve shoqërore.

- Njësitat e qeverisjes vendore ndihmojnë grupet në nevojë nëpërmjet shpërndarjes së burimeve ekonomike që kanë në dispozicion.
- Shërbimet shoqërore që ofron bashkia janë në formën e ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë, shërbime të përkujdesit social, rezidencial dhe komunitar.
- Bashkia harton sistemin e integruar të ndërhyrjeve për shërbimet sociale.
- Shërbimi social në Bashki koordinon administrimin e të gjitha burimeve duke iu përgjigjur kërkesave sociale.



Kategoritë e subjekteve që përfitojnë pagesën e paaftësisë janë:

- ✓ Paraplegikët dhe tetraplegikët, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP);
- ✓ Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, i Shërbimit Social Shtetëror;
- ✓ Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.



Dokumentacioni i nevojshëm përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar:

- ✓ Çertifikata e gjendjes familjare;

Materialet informuese janë përgatitur nga ekspertët e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të iniciativës me temë “Monitorimi dhe përmirësimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale në nivel vendor (Tiranë, Fier, Berat, Pogradec)”, me mbështetjen e United States Agency for International Development (USAID). Opinionet e shprehura në këtë material nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e United States Agency for International Development (USAID)

- ✓ Çertifikata personale me fotografi ose kopje e letër njoftimit;
- ✓ Vendimin e mëparshëm të KMCAP-it, i cili vërteton shkallën e aftësisë së kufizuar të personit;
- ✓ Fletëdrejtimin për në KMCAP, kur personi paraqitet për herë të pare;
- ✓ Epikrizën përcjellëse, sa herë që ri-paraqitet.



Procedura e aplikimit

- Së pari, qytetarët duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në seksionet e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore të bashkisë;
- Ky seksion dërgon me proces-verbal pranë mjekut të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, listën e personave, që do të paraqiten apo ri-paraqiten pranë KMCAP-it së bashku me dokumentacionin përkatës;
- Mjeku verifikon nëse dosjet janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe i dërgon në KMCAP;
- Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, në përfundim të vlerësimit, dërgojnë listat e personave të deklaruar invalidë pune tek Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe një kopje të vendimit të KMCAP për çdo person;
- Invalidët e punës, duhet të paraqesin pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore, ku ata kanë vendbanimin, Vërtetimin Tip të leshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore;

Rol i Institucionit të Avokatit të Popullit

Çdo qytetar që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë apo interesat e ligjshëm nga veprimet/mosveprimet paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike mund ti drejtohet Avokatit të Popullit;

Institucionit të Avokatit të Popullit mund ti drejtoheni nëpërmjet kërkesës, ankesës dhe njoftimit. Për to nuk kërkohet ndonjë formë e caktuar por duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesës dhe të mos jenë anonyme.



Ku dhe si mund të ankoheni ndaj refuzimit të përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar?

- Së pari, mund të ankoheni me shkrim brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
- Së dyti, qytetari ka të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror brenda 10 ditëve nga data e marjes së përgjigjes nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror;
- Gjithashtu mund të ankoheni pranë Gjykatës Administrative në përpunë me dispozitat e ligjit në fuqi mbi gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative;
- Së fundmi, mund ti drejtoheni me një ankesë, kërkesë dhe njoftim Avokatit të Popullit.

Për çdo informacion shtesë lidhur me këto shërbime, ju mund ti referoheni faqeve web të bashkive përkatëse si dhe në linqet e meposhtme:
www.portavendore.al / info@sherbimisocial.gov.al

Ju mirëpresim në forumet dhe diskutimet tona



www.altri.al



qendra.altri@gmail.com / info@altri.al



Qendra ALTRI



Qendra ALTRI